

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit ekonomik "Novamat" sh.p.k, NIPT K81615002O, me adresë Rruga "Ismail Qemali", Njësia Bashkiake Nr. 5, Pallati Samos Tower, kati i 8, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur, mbi kufirin e lartë monetar - mallra - me mjete elektronike.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF - 02306-08-04-2021.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Rinovimi i sistemit të mbrojtjes për dy agregatë me vendosje/konfigurim të releve të reja që zëvendësojnë ato ekzistuese REG, RET në HEC Fierzë".

Kohëzgjatja e kontratës: 15 (pesëmbëdhjetë) muaj, nga hyrja në fuqi e kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Datë 09/08/2021, Nr.119.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1- "Novamat" sh.p.k, NIPT K81615002O, me ofertë ekonomike 73,500,000 (Shtatëdhjetë e tre milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH;

2- "Divitech" sh.p.k, NIPT L01306049O, me ofertë ekonomike 74,400,000 (Shtatëdhjetë e katër milion e katërqind mijë) Lekë pa TVSH;

3- "Intracom Telecom Albania" sh.p.k, NIPT K12006001H, pa ofertë ekonomike.

I - Është skualifikuar operatori ekonomik "Intracom Telecom Albania" sh.p.k, NIPT K12006001, pasi ka paraqitur vetëm profilin e kompanisë dhe asgjë nga kriteret për kualifikim të kërkuara në DT.

II - Janë kualifikuar operatorët ekonomik "Novamat" sh.p.k, NIPT K81615002O dhe "Divitech" sh.p.k, NIPT L01306049O, pasi kanë paraqitur ofertën konform kërkesave të Dokumentave të Tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "Novamat" sh.p.k, NIPT K81615002O, me adresë Rruga "Ismail Qemali", Njësia Bashkiake Nr.5, Pallati Samos Tower, kati i 8, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 73,500,000 (Shtatëdhjetë e tre milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23/12/2020, "Për Prokurimin Publik".

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ERGYS VERDHO